




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-4300/14
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 20.11.2014
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.11.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3929/14, për z. Rexhep Kabashi – ish Prokuror – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për arsye se i njëjti, tashmë, ka mbaruar mandatin e prokurorit dhe ndërkohë nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik, prandaj nuk ka konflikt interesi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3929/14, për z. Rexhep Kabashi – Ish Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Avokat Rexhep Kabashi”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pasi ka filluar procedura për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit është kuptuar se z. Kabashi tashmë nuk është zyrtar i lartë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për shkak se i ka mbaruar funksioni i tij publik si prokuror dhe nuk ka marrë ndonjë funksion tjetër si zyrtar i lartë publik.

Këtë e kemi konfirmuar nga formularët e zyrtarëve të lartë të cilat i kanë dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit, pas mbarimit të funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

